

STATUT

PER SHOQERINE TREGETARE " Ernesto - TEX"

Sot me daten 10-12-2019, Une ortak i vetem: **MARIGLEN AZBI DAJLANI**, i datelindjes 06-03-1993, me karte identiteti nr. 030532294, me nr. personal J30306005W, madhore e me zotesi te plote per te vepruar, konform ligjit 9901 date 14-04-2008 " " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", dhe ne **AKT-THEMELIMIN** date 10-12-2019 te shoqerise tregtare " Ernesto - TEX" si ortak i vetem hartoj statutin e kesaj shoqerie tregtare.

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 1

Shoqeria tregtare eshte me pergjegjesi te kufizuar, me statusin e personit juridik shqiptar.

NENI 2

Emertimi i shoqerise tregtare eshte " Ernesto - TEX" shpk e krijuar me akt-themelimin e ortakut te vetem te shoqerise **Mariglen Dajlani**, me mjetet e tija financiare.

NENI 3

Selia dhe qendra e kesaj shoqerie eshte ne:

Kuçove Lagjja " 1 Maj ", rruga " Thimi Tani ", godina nje kateshe me nr. 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregetare eshte:

Veprimtari ne fushen e tregtise. Import – eksport artikuj te ndryshem industrial me shumice dhe pakice pa kufizim.

NENI 5

Ky objekt veprimtarie, mund te shtohet, pakesohet apo ndryshohet me vendimin e ortakut te vetem.

MJETET E SHOQERISE TREGETARE

NENI 6

Shoqeria tregetare " Ernesto - TEX" SHPK per fillimin e veprimtarise se saj ka nje kapital fillestar prej 100.000 leke , prone e ortakut te vetem te shoqerise , te ndara ne 1 kuote , kapital i cili do shlyhet pas regjistrimit te shoqerise ne QKB.

NENI 7

Me mjetet e shoqerise tregetare, kuptohen edhe ato objekte, sende dhe te holla qe do te fitohen ne te ardhmen nga ushtrimi i veprimtarise tregetare te kesaj shoqerie.

NENI 8

Per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve ndaj shtetit dhe personave te trete, juridike apo fizike, si dhe per te shtuar veprimtarine e saj, shoqeria tregetare, krijon nje fond reserve prej 1/20 e fitimit te vitit paraardhes financiar.

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 9

-Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte Ortaku i vetem, vendimet e te cilit jane te ligjshme dhe te detyrueshme.

-Shoqeria administrohet nga administratori, i cili ka per detyre te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise

Administratore i shoqerise eshte **Z. Mariglen Dajlani**, i biri i **Azbi-ut**, i datelindjes **06-03-1993**, me karte identiteti **030532294**, me numer personal **J30306005W**, madhor e me zotesi te plote per te vepruar

Administratori caktohet per **5(pese) vjet**, me te drejte rizgjedhjeje.

ORTAKU I VETEM

NENI 10

Ortaku i vetem i saj , ka keto kopetenca:

- Ndryshimin e selise se shoqerise dhe emertimin e saj.
- Vendos lidhur me pagat e punonjesve te shoqerise.

-Ben ndryshimet e çfaredoshme ne statutin e shoqerise.

-Perfaqeson shoqerine ne marredhenie me shtetin ose persona te tjere juridik e fizike.

-Nese administrator do te vendoset nje person tjeter jo ortak, emeron ose e shkarkon ate sipas rastit..-

Ushtron te gjith kopetencat e tjera te parashikuara ne ligjin shqiptar ,ne kete statut,akt themelim apo akte te tjera juridike te mevoneshme, duke patur te drejten qe t'u delegoje edhe punonjesve te tjera kopetenca.

NENI 11

Administratori kur largohet perkohesisht, vendos me shkrim zevendesin e tij, duke i percaktuar qarte dhe ne menyre konkrete detyrimet dhe kopetencat qe ai mban per ate periudhe mungese. Zevendesi nuk ka te drejte te dale jashte tagrave te dhena

NENI 12

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe:

- 1-Librin e ortakeve, ne te cilin shenohet emri i plote dhe kuota e kapitalit.
- 2-Libri i mbledhjeve dhe i veprimeve te organit vendimor .
- 3-Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit administrative

ADMINISTRIMI

NENI 13

Administratori ka kopetenca:

- te veproje ne marredhenie me te tretet, te perfaqesoje shoqerine ne raporte me persona te tjere juridike ose fizike, publike ose private, bankat etj.
- Harton raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.

- Rregullon maredheniet e punesimit dhe shperblimit brenda shoqerise.
- Sipas akteve ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shteterore, personave fizike e juridike, shtetas ose te huaj.

- Ai nenshkruan dhe jep urdhera per veprimet financiare te shoqerise, emerone punonjesit e thjeshte teknike te shoqerise, nenshkruan listpagesen e punonjesve, urdheron dhenien e dietave per punonjesit ose shperblim e stimuj per persona te tjere jashte saj qe veprojne per llogari te kesaj shoqerie, ka te drejte te informohet per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me dokumentat e saj dhe llogarite perkatese ne rast se keto mbahen nga persona te tjere te caktuar prej tij.

- Administratori ka te drejte te marre vendime dhe te nxjerre urdhera ne funksion te veprimtarise qe zhvillon shoqeria sipas kopetencave te dhena nga statute dhe ligji per shoqerite tregetare

Ai ka te drejte te marre pjese ne shitblerje, procedura falimentimi, te tjetersoje pasuri te patundshme e te tundshme, te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare ose te huaja , te perfaqesoje shoqerine ne organet gjyqesore e administrative.

I pajisur me prokure te posacme nga assembleja, administratori mund te kaperceje dhe te veproje edhe pertej kufizimeve te siperpermendura ne kete nen. Ai merr te gjitha vendimet qe jane ne interes e punes per problemet e emergjences, vendos per marrjen ne pune dhe largimin apo pushimin nga puna te personave qe ka ne varesi administrative.

- Administratori ka te drejte te marre vendime dhe te nxjerre urdhera ne funksion te veprimtarise qe zhvillon shoqeria sipas kopetencave te dhena nga statute dhe ligji per shoqerite tregetare.

-Ai ka te drejte te marre pjese ne shitblerje, procedura falimentimi, te tjetersoje pasuri te patundshme e te tundshme, te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare ose te huaja , te perfaqesoje shoqerine ne organet gjyqesore e administrative.

I pajisur me prokure te posaçme nga assembleja, administratori mund te kaperceje dhe te veproje edhe pertej kufizimeve te siperpermendura ne kete nen. Ai merr te

gjitha vendimet qe jane ne interest e punes per problemet e emergjences, vendos per marrjen ne pune dhe largimin apo pushimin nga pun ate personave qe ka ne varesi administrative.

Administrator mund te jete ortaku i vetem ose nje person tjetër ose administrator mund te jene dy persona njekohesisht.

NENI 14

Administratori zgjidhet nga ortaku i vetem (ose Asambleja e ortakeve kur shoqeria ka me shume se nje ortak) per afat 5- vjeçar me te drejte rizgjedhje

Administratori e pushon veprimtarine e tij kur:

-Jep doreheqjen.

-Perfundon afati.

-Asambleja mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas depozitave ligjore ne fuqi.

FITIMI DHE NDARJA E TIJ

NENI 15

Pasi paguhen detyrimet, si taksa, si tatime, shpenzime te tjera te domosdoshme, pagat e punonjesve te shoqerise, mbetet fitim neto, i cili eshte ne favor te ortakut te vetem **Mariglen Dajlani**

Nga fitimi i realizuar ndahen stimuj per punonjesit me vendim te ortakut te vetem.

Ortaku i vetem mbart mbi vete, rrezikun e falimentimit deri ne masen 100% te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

ORGANIZIMI I PERDITSHEM

NENI 16

Per mirefunksionimin e shoqerise tregtare, ortakut i vetem ne rolin e administratorit ben ndarjen e puneve, duke e organizuar edhe ne njesi te vogla, sipas percaktimit te tij.

NENI 17

Me vendim te ortakut te vetem kjo shoqeri tregtare mund te çele filial ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERINE TREGETARE

NENI 18

Ne shoqerine tregtare “**Ernesto - TEX**” shpk mund te futen ortake te tjere te rinj , ne kushtet qe percaktohen ne kontraten e bere ne kete rast,sipas vendimit te ortakut te vetem.

NENI 19

Per punonjesit e tjere te shoqerise behen kontrata kolektive dhe individuale te punes ,sipas parashikimeve ne legjislacionin shqiptar te punes

NENI 20

Punonjesi i shoqerise tregtare pergjigjet disiplinarisht, materialisht dhe penalisht nese eshte rasti, kur shkel detyrimet e veta sipas kontrates se punes , per demet qe mund t'i sjell shoqerise tregtare me veprimet ose mosveprimet e tij te fajshme.

KOHEZGJATJA DHE MBYLLJA E SHOQERISE

NENI 21

Shoqeria tregtare krijohet per te ushtruar aktivitetin me nje afat kohor mbi 10 vjet pune te njepasnjeshme.

NENI 22

Kjo shoqeri tregtare, mbyllet sipas parashikimeve te bera ne legjislacionin shqiptar dhe atyre te parashikuara ne statutin e vet.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 23

Shoqeria merr personalitet juridik me regjistrimin ne regjistrin tregetar prane QKB.

Shoqeria ka adrese email – ernesto.textil2019@gmail.com

NENI 24

Nje kopje e ketij statuti dhe nje kopje e akt-themelimit se bashku me vendimin depozitohen ne Qendren e Regjistrimit te Bizneseve.

ORTAKU I VETEM

Morizlen Dajlani